

RAPORTI I KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKTLIGJIN “PËR KONCESIONET DHE PARTNERITETIN PUBLIK PRIVAT”

Raport për rezultatet e konsultimit publik

1. Titulli i draft aktit

Projektligji “Për koncesionet dhe partneritetin publik privat”.

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Konsultimet në portalin e regjistrimit elektronik: 20 ditë pune, 09.5.2025 deri në datën 11.06.2025.

3. Metoda e konsultimit

Metodat e konsultimit publik të përdorura si vijon:

Konsultimi në portalin “Regjistri Elektronik për Njoftimet dhe konsultimet Publike” për periudhën 09.5.2025 deri në datën 11.06.2025. gjatë së cilës janë përcjellë komente përmes këtij protali.

Projektligji, relacioni shpjegues, dokumenti i konsultimit publik janë publikuar në RENJK ku çdo i interesuar është njohur me dokumentet përkatëse. Gjithashtu, institucionet me të cilat është kryer konsultimi janë njohur me këto dokumente përmes përcjelljes së tyre në rrugë zyrtare. Kontributet në kuadër të procesit të konsultimit dhe përmirësimit të përmbajtjes së projektligjit, janë përcjellë nëpërmjet postës elektronike dhe regjistrimit elektronik.

4. Palët e interesit të përfshira

Për hartimin e këtij projekt akti është ngritur grupi ndërinstitucional i punës me urdhrin nr.57 datë 18.4.2024 të Kryeministrit "Për ngritjen e grupit ndërinstitucional të punës për rishikimin e ligjit nr.125/2013 "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", të ndryshuar me kontributin e ministrisë së Financave dhe Agjencinë e Prokurimit Publik. Konsultime të detajuara janë zhvilluar me ekspertët e SIGMA, të cilët kanë ofruar komente dhe rekomandime të rëndësishme lidhur me aspektet kyçe të procedurave për koncesionet dhe partneritetin publik-privat. Vërejtjet e tyre kanë përfshirë çështje si kufijtë financiarë, rastet e përjashtimit, listën e autoriteteve kontraktuese, format e procedurave të dhënies me koncesion, nënkontraktimin, menaxhimin e kontratave, dhe jo vetëm. Duke pasur parasysh rëndësinë e përafrimit me legjislacionin vendas dhe kërkesat e përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare, këto rekomandime janë integruar në mënyrë të plotë në draftin e projektligjit për koncesionet, duke përmirësuar kështu kuadrin ligjor dhe funksionimin e tij praktik.

RAPORTI I KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKTLIGJIN “PËR KONCENSIONET DHE PARTNERITETIN PUBLIK PRIVAT”

5. Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

<p>Çështja e adresuar <i>(psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)</i></p>	<p>Komenti <i>(grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)</i></p>	<p>Palët e interesuara <i>(renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)</i></p>	<p>Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)</p>	<p>Justifikimi</p>
<p>Qartësia e përkufizimeve në projektligj</p>	<p>Bazuar në nenin 8, pika 1 dhe nenin 30, pika 3, shprehet se këto dy pika mund të shkelen, sepse termat mund të perceptohen ndryshe dhe, si rrjedhojë, vendimet do të jenë ndryshe në favor të disa personave. Kërkohet që çdo term të ketë një përkufizim të qartë, mbi të cilin bien dakord të gjitha palët, si dhe të vendoset një sistem monitorimi.</p>	<p>Individ</p>	<p>Pranuar pjesërisht</p>	<p>Lidhur me këtë koment sqarojmë se: Këto janë parime të cilat janë të transpozuara nga Direktiva e Koncesioneve 2014/23/EU, zbatimi i të cilave garantohet në të gjithë frymën e projektligjit.</p>

RAPORTI I KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKTLIGJIN “PËR KONCENSIONET DHE PARTNERITETIN PUBLIK PRIVAT”

<p>Qartwsia/zbatueshmwria</p>	<p>Sugjerojnë shoqërimin e dispozitave me dokumente shpjeguese (recitalet e BE-së) dhe me praktikat e Gjykatës Evropiane të Drejtësisë, për një kuptim më të saktë të ligjit.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sugjerojnë parashikimin e mekanizmave të zbatueshmërisë; të përfshihen dispozita që garantojnë zbatimin efektiv të ligjit dhe proceseve. • Të krijohen struktura vlerësimi për projektet, me standarde të përcaktuara që sigurojnë paanshmëri dhe pavarësi. • Sugjerojnë forcimin e raportimit të ATRAKO-s përmes detyrimit për raportim te një organ i pavarur, si Kontrolli i Lartë i Shtetit. • Sugjerojnë shtimin e një neni të posaçëm që ndalon shmangien e procedurave përmes projekteve të veçanta që nuk ndjekin procesin ligjor. • Sugjerojnë eliminimin e dispozitave për përjashtime speciale, për të shmangur 	<p>Dhoma Amerikane e Tregtisë</p>	<p>Pranuar pjesërisht</p>	<p>Lidhur me këto komente/sugjerime sqarojmë se: Duke ndjekur të njëjtën qasje si në fushën e prokurimit publik, rregullime më të detajuara do të parashikohen në aktet nënligjore përkatëse. Zbatimi i parimeve themelore të përcaktuara në nenin 8 është parashikuar si detyrim edhe në dispozita të tjera të projektligjit, të cilat lidhen me zhvillimin e procedurave përkatëse. Gjithashtu, zbatimi i këtyre parimeve garantohet në të gjithë frymën e projektligjit. Komenti i tretë është pranuar. Dispozita përkatëse është rishikuar, me qëllim që të jetë në përputhje me kërkesat e Direktivës 2014/23/EU. Sqarojmë se ky parashikim është bërë duke marrë në konsideratë mjedisin konkret të zbatimit të ligjit, ku mungesa e një kufizimi të tillë do të mundësonte hapësirë për abuzime nga operatorët ekonomikë. Në këtë kuptim, kufizimi në fjalë është në përputhje me parimet e transparencës dhe barazisë, si dhe në frymën e luftës kundër korrupsionit në fushën e koncesioneve dhe partneriteteve publik-privat (PPP).</p>
-------------------------------	--	-----------------------------------	----------------------------------	---

RAPORTI I KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKTLIGJIN “PËR KONCENSIONET DHE PARTNERITETIN PUBLIK PRIVAT”

	<p>abuzimet dhe trajtimin e pabarabartë.</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sugjerojnë kufizimin e kohëzgjatjes së një koncesioni, në përputhje me direktivat e BE-së. • Sugjerojnë që, në rast të ndryshimeve të rëndësishme në kontrata, të specifikohet se kufizimi për vlerën e modifikimeve zbatohet për secilin modifikim veç e veç, jo vetëm në total. • Sugjerojnë heqjen e përqindjes së paracaktuar për nënkontraktimin dhe lejimin që kjo të përcaktohet rast pas rasti nga autoriteti përkatës. 			
<p>Projektligji</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Konstatojnë mungesë garancish ligjore për prishjen e kontratave në rast keqmenaxhimi apo pasaktësish në transferimin e pronësisë; • Konstatojnë mungesë të dispozitave mbi kontrollin e integritetit të pronarëve përfitues dhe mungesa e klauzolave të transparencës; 	<p>Albanian Institute of Science</p>	<p>Pranuar pjesërisht</p>	<p>Lidhur me këto komente/sugjerime sqarojmë: Projektligji është ripunuar në terësi. Neni 16 është hartuar sipas nenit 28 të Direktivës së Koncesioneve. Fusha e zbatimit është bazuar në parashikimet e Direktivës së Koncesioneve. Komenti për koncesionin 1/euro pranohet. Tashmë kjo pikë është hequr në projektligj. Sikurse është saktësuar në këtë nen, rregullime të mëtejshme do të përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Propozimet e pakërkuara, sipas përcaktimeve të këtij projektligji,</p>

RAPORTI I KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKTLIGJIN “PËR KONCENSIONET DHE PARTNERITETIN PUBLIK PRIVAT”

	<ul style="list-style-type: none"> • Konstatojnë mungesë konsultimi me grupet e interesit dhe shoqërinë civile gjatë hartimit të ligjit; • Nuk përshihet roli i njësisve të qeverisjes vendore dhe mungon qartësimi mbi decentralizimin në zbatim; • Sugjerojnë organizimin e një tryeze publike konsultimi me OJF-të, institucionet e drejtësisë, integritit dhe të qeverisjes vendore; • Sugjerojnë përfshirjen e Ministrisë së Drejtësisë, të Brendshme dhe institucioneve të tjera relevante në grupin e punës; • Sugjerojnë krijimin e një regjistri elektronik, të hapur dhe të aksesueshëm nga publiku për kontratat PPP dhe koncesione; • Problematikat në nenet specifike si më poshtë: Neni 16: Kriteri i konfidencialitetit nuk duhet të lejojë fshehjen e të dhënave nga OE, apo partnerët privatë. Dokumentacioni dhe informacioni i detyrueshëm 			<p>jepen vetëm për realizimin e punimeve dhe/ose shërbimeve në: porte, aeroporte, energjinë për ngrohje dhe shpërndarjen e gazit natyror, për prodhimin dhe shpërndarjen e energjisë elektrike.</p> <p>Në nenin 18 të projektligjit, autoriteteve/enteve kontraktore u jepet mundësia për marrjen e një ekspertize të jashtme. Rregullimet sa i takon fushës së zbatimit dhe autoriteteve/enteve kontraktore janë bazuar në dispozitat e Direktivës së Koncesioneve.</p>
--	---	--	--	--

RAPORTI I KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKTLIGJIN “PËR KONCENSIONET DHE PARTNERITETIN PUBLIK PRIVAT”

	<p>për publikun është i përkufizuar ngushtë.</p> <p>Neni 4: Zgjerim i tepruar i fushës së zbatimit, duke përfshirë sektorë si siguria, burgjet, arsimi e drejtësia. Në po këtë nen, pika 3 koncepton koncesion me çmim 1 euro, është e tepruar dhe nuk duhet të lejohet nga ligji.</p> <p>Neni 10 pika 6: Duhet parashikuar publikimi i pasqyrave financiare në regjistrin koncesionar.</p> <p>Neni 12: Funksionimi dhe buxhetimi i Agjencisë së Trajtimit të Koncesioneve është i paqartë dhe i mbështetur në donacione.</p> <p>Neni 15: Nuk garanton transparencë dhe akses publik të mjaftueshëm.</p> <p>Neni 19 pika d: Lejon propozime të pakërkuara në shumë sektorë strategjikë, pa kufizime.</p>			
--	--	--	--	--

RAPORTI I KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKTLIGJIN “PËR KONCENSIONET DHE PARTNERITETIN PUBLIK PRIVAT”

	<p>Neni 20 pika b: Ngarkon komisione me kapacitete të kufizuara për hartimin e studimeve të fizibilitetit.</p> <p>Projektligji paraqet mangësi serioze në aspektin e transparencës, përfshirjes së grupeve të interesit dhe sigurisë juridike. Kërkohej rishikim i thelluar dhe konsultim i gjerë institucional dhe qytetar para miratimit.</p>			
Projektligj	<ul style="list-style-type: none"> • Ka mungesë të konsultimit institucional dhe përfshirjes së shoqërisë civile. Drafti nuk parashikon mekanizma për pjesëmarrjen e OJF-ve, sindikatave, dhomave të tregtisë; • Dhe nuk po zbatohet Urdhri nr. 113/2019 për konsultim publik për Kapitullin 5 të integritetit në BE; • Ka mungesë të dispozitës për “Paktin e Integritetit”. Drafti nuk kërkon nënshkrimin e marrëveshjeve për transparencë dhe monitorim të pavarur dhe kjo bie në kundërshtim me strategjinë anti-korrupsion të 2024–2030; • Drafti lejon përdorimin e procedurave me negociim pa kushte 	Institute for Democracy and Mediation	Pranuar pjesërisht	Lidhur me këto komente/sugjerime sqarojmë si vijon: Draftligji për koncesionet është diskutuar në Takimin e Tryezës së Partneritetit për Integrimin Evropian për Kapitullin 5 “Prokurimi Publik”, zhvilluar më datë 15 janar 2024. Për zbatimin e ligjit do të miratohen gjithashtu aktenënligjore. Këto mund të rregullohen me akte nënligjore. Lidhur me komentin nr.4 sqarojmë se këto janë procedura konkurruese, me disa faza dhe që janë të shpallura. Gjithashtu, sqarojmë se këto procedura janë në përputhje me parashikimet e Direktivave 2014/24/EU dhe 2014/25/EU. Sqarojmë se dispozitat të cilat lidhen me nevojat urgjente, u referohen procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të

RAPORTI I KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKTLIGJIN “PËR KONCENSIONET DHE PARTNERITETIN PUBLIK PRIVAT”

	<p>të qarta, dhe nuk caktohet numër minimal kandidatësh, duke lejuar gara me pak pjesëmarrës, e cila sjell reduktim të konkurrencës;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Sektorë si shërbimet sociale dhe arsimi mund të përfshihen pa kritere të qarta, dhe mungojnë kufizime për përzgjedhjen e projekteve me ndikim të ulët publik; • Nuk specifikohen rolet e ministrive, njësive vendore dhe komisioneve vlerësuese dhe se kjo krijon rrezik për konflikt interesi dhe mungesë transparence në vendimmarrje; • Nuk ka afate minimale për publikimin e dokumenteve dhe njoftimeve të tenderit dhe se ka mungesë transparence sidomos në nivel vendor, dhe se bashkitë nuk detyrohen të publikojnë dokumentacionin para mbledhjes së këshillit; • Neni 11/a: Flet për publikim të dokumenteve standarde të tenderit, por nuk përcakton ku dhe si duhet të publikohen specifikisht; • Neni 34 dhe 35: Përcakton 			<p>kontratës, dhe jo procedurës me negociim me shpallje paraprake. Vetë Direktiva e Koncesioneve nuk parashikon përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake, dhe rrjedhimisht as Draftligji nuk e parashikon. Sqarojmë se fusha e zbatimit të aktiviteteve të koncesioneve është në përputhje me listën e aktiviteteve të parashikuara në Direktivën e Koncesioneve. Në nenin 38, pika 3 dhe 4 të Draftligjit, janë të parashikuar afatet kohore të dërgimit të kërkesës për pjesëmarrje. Konkretisht:</p> <p>3. Afati minimal kohor për pranimin e kërkesave për pjesëmarrje, pavarësisht nëse përfshin ose jo dorëzimin e ofertës, është 30 ditë nga data në të cilën është shpallur njoftimi i kontratës së koncesionit ose ftesa për shprehje interesi.</p> <p>4. Kur procedura zhvillohet në faza të njëpasnjëshme, afati minimal kohor për pranimin e ofertave fillestare është 22 ditë nga data në të cilën është dërguar ftesa për ofertë. Dokumentet Standarde të Tenderit publikohen në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik. Neni 35 është hartuar në përputhje me nenin 36 të Direktivës së Koncesioneve, e cila nuk parashikon afat minimal. Sa i takon nenit</p>
--	---	--	--	---

RAPORTI I KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKTLIGJIN “PËR KONCENSIONET DHE PARTNERITETIN PUBLIK PRIVAT”

	<p>përmbajtjen e ftesës/dokumentacionit, por mungon afati minimal. Lejon publikimin në momentin e fundit, duke penguar përgatitjen e operatorëve lokalë;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Ka mungesë dispozite për publikimin e “statusit” të procedurës, e cila mundëson që çdo palë e interesuar mund të gjurmojë online se në ç’fazë ndodhet projekti; • Neni 14: Nuk përcakton detyrim ligjor që bashkitë të publikojnë në faqen zyrtare dokumente paraprake, dhe asnjë nen nuk e kërkon publikimin të paktën 15 ditë para mbledhjes së Këshillit Bashkiak, gjë e cila pengon konsultimin publik dhe transparencën vendore; • Drafti lejon ndryshime deri në 50% të vlerës fillestare pa garë të re, e cila është kundër Direktivës së BE-së. Dhe shprehen se nuk përcaktohen qartë arsyet për ndërprerjen e kontratës, dhe se lejohen transferime të të drejtave pa mekanizma të fortë kontrolli dhe vlerësimi. 			<p>34, lutemi referojuni përgjigjes së mëparshme për nenin 33. Draftligji, në tërësinë e tij, parashikon dispozita që përcaktojnë që proceset e zhvillimit të procedurave për dhënien e koncesioneve/PPP të jenë të publikuara (p.sh. njoftimi i kontratës, njoftimi i fituesit, njoftimi i nënshkrimit të kontratës etj.). Neni 14 nuk flet për procesin e konsultimit publik, por parashtron se cilët organe konsiderohen si autoritete/ente kontraktuese për qëllime të këtij projektligji.</p> <p>Sqarojmë se, sipas pikës 4 (c) të nenit 60 të Projektligjit, kontrata e koncesionit mund të ndryshohet pa procedurë të re të përcaktuar me këtë ligj, kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:</p> <ol style="list-style-type: none"> nevoja për ndryshim ka lindur si rezultat i rrethanave të jashtme që autoriteti kontraktues ose enti kontraktues nuk mund t’i parashikonte; ndryshimi nuk ndryshon natyrën e përgjithshme të kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat; dhe nuk kalon pesëdhjetë për qind (50%) të vlerës së kontratës fillestare për çdo modifikim.
--	---	--	--	---

RAPORTI I KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKTLIGJIN “PËR KONCENSIONET DHE PARTNERITETIN PUBLIK PRIVAT”

				<p>Ndërkohë, Direktiva 2014/23/EU, dispozitat sa i takon ndryshimit të kontratës i ka të parashikuara në nenin 43, i cili, po ashtu në pikën 1 (b), paragrafi i tretë, saktëson se: “Megjithatë, në rastin e koncesioneve të dhëna nga një autoritet kontraktues, për qëllime të ndjekjes së një aktiviteti tjetër nga ato të përmendura në Shtojcën II, çdo rritje në vlerë nuk duhet të kalojë 50% të vlerës së koncesionit fillestar”. Në këtë kuadër, parashikimet e pikës 4 (c) të nenit 60 të Projektligjit janë në përputhje me Direktivën. Dispozitat për ndërprerjen e kontratës janë të parashikuara në nenin 64 të Projektligjit.</p>
<p>Projektligji</p>	<ul style="list-style-type: none"> • Neni 10, pika 2: Miratimi nga MF bëhet shumë vonë (vetëm në fazën e fizibilitetit), kur projektet tashmë kanë marrë hov – rekomandohet përfshirja në fazën e konceptit/idesë dhe nevojitet formalizimi i hapave përgatitore para vlerësimit të fizibilitetit, pasi mungojnë në draft; • Neni 10, pika 5: Rreziqet duhet të kategorizohen si kontraktuale apo të nënkuptuara, jo thjesht si direkte/indirekte; 	<p>FAD IMF Departamenti i Çështjeve Fiskale - FMN</p>	<p>Pranuar pjesërisht</p>	<p>Lidhur me këto komente/sugjerime sqarojmë se: Projektligji është strukturuar fillimisht me qëllim që të jetë në harmoni me Vendimin nr. 887, i cili, përpara ndryshimeve të tij në vitin 2025, parashikonte që për projektet mbi një prag të caktuar, të hartohesh dhe miratohesh paraprakisht një studim fizibiliteti. Për të gjitha projektet që kalojnë këtë prag dhe që janë pjesë e Listës Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare, ligji parashikon që studimi i fizibilitetit të jetë i gatshëm dhe jo i hartuar nga Komisioni i Dhënies</p>

RAPORTI I KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKTLIGJIN “PËR KONCENSIONET DHE PARTNERITETIN PUBLIK PRIVAT”

	<ul style="list-style-type: none"> • Neni 10, pika 7; Neni 19, d dhe Neni 48: Duhet eliminimi i propozimeve të pakërkuara, pasi përbëjnë 80 % të PPP-ve dhe rrisin rrezikun për vendimmarrje jo transparente; • Duhet të hiqet rimbursimi i studimeve të fizibilitetit për projektet e refuzuara, sepse krijon nxitje për shumë propozime pa cilësi; • Draft ligji heq vlerësimin strategjik nga Agjencia e Planifikimit – rrezik për projekte që s’janë në përputhje me prioritetet zhvillimore; • Heqja e miratimit nga Këshilli i Ministrave krijon pasiguri në përgjegjësi e vendimmarrje; • Neni 13, pika 1: Komiteti i Përzgjedhjes së PPP-ve miraton studimet në fazë të vonë – duhej të përfshihej më herët (koncept/ide); • Neni 40, pika 2: Prezanton Komitetin e Dhënies së Koncesioneve – por kërkon qartësi nëse vlen edhe për PPP-të; • Neni 30, pika 5 & Neni 10, pika 8: Këshilli i Ministrave ka rol 			<p>së Koncesionit. Ju lutemi referojuni nenit 20, pika 4, shkronja (b).</p> <p>Ligji, gjithashtu, lejon që studimet e fizibilitetit të hartohen në përputhje me legjislacionin për Menaxhimin e Investimeve Publike (PIM), i cili ka pasur dhe ka një pipeline të detajuar projektesh. Megjithatë, për projektet me vlerë më të vogël, si dhe për projektet koncesionare/PPP të njëjësive të vetëqeverisjes vendore (të cilat zakonisht janë të vogla në përmasa), ky standard mund të rezultojë tepër i ngurtë, por gjithashtu paraqet një ngarkesë disproporcionale për Ministrinë e Financave.</p> <p>Duke pasur parasysh kufizimet në burimet njerëzore, konsiderohet më e arsyeshme që ato të përqendrohen në projektet me rëndësi të veçantë, sesa të shpërndahen në mënyrë të barabartë që në fazën fillestare të çdo procedure. Megjithatë, do të vlerësonim nëse do të na dërgonit disa sugjerime që mund të përfshihen në aktet nënligjore që do të miratohen brenda një afati tremujor. Kujtojmë gjithashtu se kuadri aktual ligjor parashikon që parafizibiliteti të përgatitet nga autoritetet kontraktuese dhe t’i dërgohet ATRAKO-s, së bashku</p>
--	--	--	--	---

RAPORTI I KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKTLIGJIN “PËR KONCENSIONET DHE PARTNERITETIN PUBLIK PRIVAT”

	<p>për rregullat e prokurimit, por mungon qartësia në zbatimin për PPP-të;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Neni 20: Komisioni i PPP-ve nuk duhet të hartojë vetë studimin e fizibilitetit, për të shmangur konfliktin e interesit – kjo duhet t’u lihet ministrive përkatëse; • Neni 30, pika 2: Lejon autoritetin kontraktues të organizojë vetë procedurën e dhënies së PPP-së – krijon konflikt interesi dhe mungesë paanësie; • Neni 22: Vendosja e pragut monetar për PPP është e diskutueshme, nëse ka mekanizma të tjerë për menaxhimin e rrezikut fiskal; • Mungon përmendja e tavanit vjetor për pagesat buxhetore për PPP-të (aktualisht 5 % të të ardhurave). • Nëse vlera e projektit rritet me 20 %, kërkohet vlerësim i ri i kostos-përfitimit; • Neni 60: Ndryshimet në kontrata duhen lejuar vetëm pas një periudhe kohe të caktuar (p.sh. 2 vite), siç ndodh në disa vende. 			<p>me kërkesën për emërimin e dy anëtarëve të Komisionit të Dhënies së Koncesionit. Ju lutemi referojuni nenit 3, pika 3, të VKM-së nr. 575.</p> <p>Mund të merret në konsideratë edhe mundësia që këto informacione t’i dërgohen Ministrisë së Financave në momentin e njoftimit për synimin për të nisur një procedurë koncesionare/PPP. Ky është thjesht një sugjerim, por jeni të lutur të ndani çdo propozim tjetër që e konsideroni të përshtatshëm. Për projektet që bien brenda fushës së zbatimit të legjislacionit për Menaxhimin e Investimeve Publike (PIM), do të ndiqen hapat sipas këtij legjislacioni. Ju lutemi referojuni komenteve të mësipërme.</p> <p>Për projektet e tjera, të cilat janë nën pragun e përcaktuar nga PIM ose jashtë fushës së tij të zbatimit, mund të detajojmë procedurën përkatëse në vendimin e ri të Këshillit të Ministrave.</p> <p>10.5 – Termi “explicit” dhe “implicit” nuk gjendet në terminologjinë e legjislacionit shqiptar. Më e përafërta e mundshme janë “direkte” dhe “indirekte”.</p> <p>10.7 – Ju lutemi shihni detyrat dhe përgjegjësitë e Njësisë së Zbatimit të</p>
--	---	--	--	--

RAPORTI I KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKTLIGJIN “PËR KONCENSIONET DHE PARTNERITETIN PUBLIK PRIVAT”

	<p>Koment, datë 11.6.2025</p> <ul style="list-style-type: none"> • Nevojitet më shumë qartësi mbi përgjegjësitë e MF në të gjitha fazat e PPP-ve. Sugjerohet shqyrtimi i propozimeve, pjesëmarrja në negociata dhe miratimi i kontratës fiskale. Gjithashtu të sqarohet roli i institucionit përgjegjës për planifikimin strategjik në proces; • Shprehen se projektligji nuk përfshin qartë marrëdhënien me kuadrin ligjor ekzistues të investimeve publike, të rregulluar nga DCM 887 (i ndryshuar në prill 2025); sugjerojnë që projektligji duhet të pasqyrojë se cilat projekte PPP i nënshtrohen këtij kuadri dhe në çfarë mase; • Të përfshihet analiza e efikasitetit, rreziqeve fiskale dhe detyrimeve të mundshme për shtetin në studimin e fizibilitetit; • Neni 25 “Shërbime të tjera specifike”:Termi është i paqartë; kërkohet qartësi nëse këto projekte përjashtohen nga ligji apo jo. Sugjerohet rishikimi i nenit 25, pika 1; 			<p>Kontratës. 7.1 – Pranuar.</p> <p>Propozimi i pakërkuar është hequr, por gjithsesi sqarohet se varianti i mëparshëm (neni 48) parashikonte që nëse:</p> <p>a) procedura e nisur nga propozimi i pakërkuar rezulton e suksesshme, dhe b) propozuesi nuk shpallet fitues i procedurës,</p> <p>atëherë ai mund të kompensohet deri në masën 1% të kostove të investimit.</p> <p>Pra, nuk ekzistonte rreziku i një numri të madh propozimesh të pakërkua, pasi për të përfituar kompensim, ideja duhej të rezultonte e suksesshme dhe të përfundonte me lidhjen e një kontrate, dhe njëkohësisht, fituesi nuk duhej të ishte vetë propozuesi.</p> <p>Gjithsesi, të gjitha parashikimet për propozimin e pakërkuar janë hequr.</p> <p>Sa i takon vlerësimin për projektet strategjike, projektligji për koncesionet mban një qëndrim neutral në lidhje me mënyrën se si legjislacioni për Menaxhimin e Investimeve Publike (PIM) do të përshtatet ose ndryshohet (duke qenë se, në fund të fundit, VKM nr.</p>
--	---	--	--	---

RAPORTI I KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKTLIGJIN “PËR KONCENSIONET DHE PARTNERITETIN PUBLIK PRIVAT”

	<ul style="list-style-type: none"> • Neni 48 “Propozimet e pakërkuara”:FMN rekomandon heqjen e tyre, sipas rekomandimeve të vitit 2023, për të shmangur rreziqet e keqmenaxhimit; • Kërkohet raportim tremujor për rreziqet fiskale, jo vetëm vjetor; • Neni 7, pika 1, c:Lista e rreziqeve fiskale duhet të harmonizohet me Udhëzimin nr. 35/2019. 			<p>877 rrjedh nga një ligj tjetër). Megjithatë, ai parashikon që, për projektet që bien brenda fushës së zbatimit të këtij legjislacioni, dispozitat përkatëse të tij të zbatohen në mënyrë të përshtatshme. Ju lutemi referojuni neneve 20, pika 4, shkronja (b), si dhe neneve 21.4 dhe 21.5 të projektligjit.</p> <p>Theksojmë se të gjitha rekomandimet e dhëna deri më tani kanë theksuar nevojën që ligji për Koncesionet/PPP-të të harmonizohet me legjislacionin për PIM-in, dhe jo që ky i fundit të qeverisë investimet publike në tërësi.</p> <p>Projektligji, në formën aktuale, parashikon që për projektet që janë pjesë e Listës Unike të Projekteve me Rëndësi Kombëtare, vlerësimi, prioritizimi, studimet e fizibilitetit etj., të merren nga organet përkatëse (duke përfshirë edhe SASPAC-un), dhe më pas të kalojnë thjesht në fazën e tenderimit. Për projektet e tjera, studimi i fizibilitetit do të hartohet nga autoritetet kontraktuese dhe do të shqyrtohet nga Ministria e Financave.</p> <p>Lidhur me heqjen e aprovimit nga Këshilli i Ministrave, ju lutemi të jepni një shembull konkret. Në dijeninë dhe vlerësimin tonë, nuk ka pasur asnjë</p>
--	--	--	--	--

RAPORTI I KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKTLIGJIN “PËR KONCENSIONET DHE PARTNERITETIN PUBLIK PRIVAT”

				<p>ndryshim të natyrës që përmendni për këtë çështje.</p> <p>Neni 13.1 – Komiteti miraton kërkesat për ekspertizë që nevojiten për hartimin e studimit të fizibilitetit. Ai nuk miraton vetë studimin e fizibilitetit. Me fjalë të tjera, nëse një autoritet kontraktues nuk ka ekspertizën e nevojshme të brendshme, ai paraqet një kërkesë pranë Komitetit, i cili e shqyrton dhe mund ta miratojë ose jo këtë kërkesë. Komiteti nuk shqyrton dhe/ose miraton vetë studimin e fizibilitetit.</p> <p>Neni 40.2 – Bëhet fjalë për të njëjtin komision me atë të përmendur në nenin 20. Vërejtja është marrë parasysh dhe do të reflektohet në përputhje me këtë.</p> <p>Neni 30.5 – Marrë në konsideratë dhe ripunuar.</p> <p>Neni 20 – Siç është sqaruar më sipër, për projektet që bien brenda fushës së legjislacionit për Menaxhimin e Investimeve Publike (PIM), zbatohen rregullat që lidhen me vlerësimin, përzgjedhjen dhe kriteret për studimet parafizibiliteti dhe fizibiliteti. Pra, për projektet më të mëdha me rëndësi kombëtare, studimet e fizibilitetit do të hartohen në përputhje me legjislacionin PIM. Për ato projekte që nuk bien brenda</p>
--	--	--	--	--

RAPORTI I KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKTLIGJIN “PËR KONCENSIONET DHE PARTNERITETIN PUBLIK PRIVAT”

				<p>fushës së zbatimit të legjislacionit PIM (kjo fushë përcaktohet nga legjislacioni përkatës dhe Ministria e Financave, e cila miraton pragjet, ndër të tjera), do të zbatohen rregullat e këtij ligji, ku studimi i fizibilitetit do të hartohet nga një komision i ngritur nga autoriteti kontraktues.</p> <p>Në thelb, ligji parashikon dy trajektoresha të ndara:</p> <p>i) njëra për projektet PIM, të cilat do të kalojnë vetëm në fazën e tenderimit nga komisioni;</p> <p>ii) tjetra për projektet e tjera, ku studimi i fizibilitetit do të hartohet nga komisioni.</p> <p>Neni 22 është një transpozim i Direktivës së BE-së 2014/23 mbi koncesionet. Sa i përket kufirit mbi pagesat vjetore për koncesionet/PPP-të, ai parashikohet në Ligjin për Menaxhimin e Sistemit të Buxhetit (Nr. 9936, datë 26.06.2008, i ndryshuar, neni 4/2 i shtuar në vitin 2016).</p>
<p>Ndryshime të tjera</p>	<ul style="list-style-type: none"> Propozojnë hartimin e udhëzuesve teknikë dhe rregullave të detajuara për monitorim dhe raportim, të cilat të jenë të 	<p>Albanian Institutes for Research</p>	<p>Refuzuar</p>	<p>Lidhur me këto komente/sugjerime sqarojmë se: Nga natyra e formulimit, këto propozime janë masa që dalin në zbatim të këtij ligji kur të hyjë në fuqi.</p>

RAPORTI I KONSULTIMIT PUBLIK PËR PROJEKTLIGJIN “PËR KONCENSIONET DHE PARTNERITETIN PUBLIK PRIVAT”

	<p>harmonizuar me kërkesat e BE-së;</p> <ul style="list-style-type: none"> • Propozojnë krijimin e një platforme online qendrore, të unifikuar dhe të aksesueshme publikisht, për publikimin e kontratave dhe të dhënave të tjera kyçe mbi PPP-të; • Propozojnë formimin e një institucioni të pavarur ose komisioni monitorimi, me autoritet të qartë ligjor dhe kapacitete teknike për auditim, analizë performancash dhe inspektime në terren; • Propozojnë sigurimin e trajnimeve për stafin publik, veçanërisht në nivel vendor, dhe përfshirjen aktive të shoqërisë civile, medias dhe auditorëve të jashtëm. 			<p>Gjithsesi, këto propozime do të shqyrtohen në vijim.</p>
--	--	--	--	---